

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-316/018	Data: Datum: 14.06.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, për caktim të mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore Hysni Zajmi në Vrellë" të cilin projekt është duke e realizuar operatori ", nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: mbikëqyrës Naser Gjocaj, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për realizim të projektit: Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore Hysni Zajmi në Vrellë".
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen për realizimin e projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projektit detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit dhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Naser Gjoci, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-317/018	Data: Datum: 14.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-20820 të datës 26.04.2018, e parashtruar nga Ramadan Alijaj, nga Istogu, i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërim, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-20820 të datës 26.04.2018, e parashtruar nga Ramadan Alijaj, për ofrim të ndihmës financiare për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 100.00€(njëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si ndihmë momentale për shërimin e tij.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Ramadan Alijaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ramadan Alijaj, ka parashtruar kërkesë Nr.06-553-20820 të datës 26.04.2018, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Ramadani, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është mjaftë i kushtueshëm.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Ramadan Alijaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen Ramadan Alijaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-318/018	Data: Datum: 19.06.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4. të Ligjit për pagat e nëpunësve civil, Nr.03/L-147 dhe nenit 22 paragrafi 2. të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr:33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, me kërkesë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-26455 e datës 01.06.2018 e parashtruar nga Daut Bujupaj nga Istogu, Komuna e Istogut dhe nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-120-26455 e datës 01.06.2018 e parashtruar nga Daut Bujupaj, Zyrtar për Emergjencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, me rastin e vdekjes së prindit-nënës Ajshe Bujupaj dhe i bëhet kompensimi në lartësi prej 345€ (treqind e katër dhjetë e pesë euro) si ndihmë familjes së lartpërmendurit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere ose kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Zyrtarja për Buxhet dhe Financa, mjetet e cekura do të transferoj në xhirollogarinë e Daut Bujupaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të Administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Daut Bujupaj, Udhëheqësi i Personelit, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Zyrtarja për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyres së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-320/018	Data: Datum: 19.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-400-23652 të datës 15.05.2018 e parashtruar nga "OJQ Vizioni 02" Qendra mësimore komunale e komuniteteve, për përkrahje me karburant për realizimin e shkollës verore 5 ditore në qytetin e Durrësit-Shqipëri, dhe nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-400-23652 të datës 15.05.2018, e parashtruar nga "OJQ Vizioni 02" për përkrahje me karburant dhe i lejohen 450 litra karburant për ndjekjen e shkollës verore 5 ditore në qytetin e Durrësit-Shqipëri, për zhvillimin e programeve të ndryshme që kanë të bëjë rreth implementimit të projekteve për mbështetje të Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për integrim të Komuniteteve: Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2017-2010 e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas motos "Të gjithë së bashku për një të ardhme me të mirë".
2. Obligohet Shefi i autoparkut që "OJQ Vizioni 02" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, 250 litra karburant nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe 200 litra karburant si dhe obligohet Zyrtari financiar në Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: ZKKK, DA dhe K dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

"OJQ-së Vizioni 02", ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-23652 të datës 15.05.2018, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet përkrahje me karburant për zhvillimin e programeve të ndryshme që kanë të bëjë rreth implementimit të projekteve për mbështetje të strategjisë së Qeverisë së Kosovës për integrim të Komuniteteve: Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2017-2010 e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas motos "Të gjithë së bashku për një të ardhme me të mirë".

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar shihet se është e një rëndësie të veçantë mbajta e kësaj shkolle verore dhe i ndihmohet me karburant për dërgimin e pjesëmarrësve të shkollës në Durrës-Republika e Shqipërisë. punimin e panos.

Shefi autoparkut do të pajisë të përmendurën me vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i ZKKK dhe DA dhe K, në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare, ZKKK dhe DA dhe K, kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Rexhë Mulaj, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-321/018	Data: Datum: 19.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses Sektorit të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit Banjë-Baicë” me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/021/521, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit Banjë-Baicë” me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/021/521, dhe në Komision caktohen:

- 1). Naser Gjoci, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë, Kryetar komisioni;
- 2). Sokol Berisha, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar; dhe
- 3). Daut Bujupi, Zyrtar për Emergjencë, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit Banjë-Baicë” si dhe do t’i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Sektori i Prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-322/018	Data: Datum: 19.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses Sektorit të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: "Rregullimi i pistës për tre hapesh në atletikë" me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/026/521, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektin: "Rregullimi i pistës për tre hapesh në atletikë" me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/026/521 dhe në Komision caktohen:

- 1). Rexhep Blakaj, Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm, Kryetar komisioni;
- 2). Bedri Hajzeraj, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar; dhe
- 3). Florije Bytyqi, Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Rregullimi i pistës për tre hapesh në atletikë" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Sektori i Prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-324/018	Data: Datum: 20.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-400-29405 të datës 21.06.2018 e parashtruar nga Klubi Alpin "Podguri" në Istog, për përkrahje me karburant, nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-400-29405 të datës 21.06.2018 e parashtruar nga Klubi Alpin "Podguri" për përkrahje me karburant dhe i lejohet furnizimi i automjetit me karburant me 80 litra, për inspektimin e tabelave orientuese të vendosura vitin e kaluar në bjeshkët e Istogut.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajis Klubi Alpin "Podguri" me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë-Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Arsim-Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Klubi Alpin "Podguri", ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-29405 të datës 21.06.2018, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet inspektimi i tabelave orientuese të vendosura vitin e kaluar në bjeshkët e Istogut.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Klubi Alpin "Podguri" dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar shihet se është e nevojshme që të inspektohen tabelat e orientimit pasi që disa prej tyre janë shkatërruar, të bëhet një raport për gjendjen e tyre në mënyrë që në të ardhmen të vendosen tjerat aty ku janë prishur apo nuk janë fare.

Indihmohet Klubi Alpin "Podguri", me 80 litra karburant për inspektimin e cekur me lartë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë-Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Arsim-Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim njoftohen: Klubi Alpin "Podguri", Drejtoria për Arsim-Spektori për Kulturë, Rini dhe Sport, Shefi i autoparkut dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-325/018	Data: Datum: 20.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-29057 të datës 19.06.2018 e parashtruar nga OJQ "Vision 02", nga Istogu, që ka të bëjë me përkrahje financiare dhe i propozoj Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa Nr.01-400-29057 të datës 19.06.2018, dhe i ndahen 500.00€ (pesëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, për përkrahje financiare për zhvillimin e aktiviteteve tradicionale multietnike ndërkufitare-shkolla verore në Durrës Republika e Shqipërisë.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Vision 02", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: OJQ "Vision 02", Drejtoria për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-327/018	Data: Datum: 21.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), bazuar në nenin 40 të Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratit e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.43/2013), më kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave kundër Aktvendimit të inspektorëve të ndërtimit dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave kundër Aktvendimit të inspektorëve të ndërtimit dhe në Komision caktohen:

- 1). Rrustem Gashi, Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, Kryetar komisioni;
- 2). Burbuqe Pepaj, Inspektore e Ndërtimit, anëtare; dhe
- 3). Faton Bujupi, Zyrtare Ligjor 2, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e ankesave kundër Aktvendimit të Inspektorëve të ndërtimit si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit.

4. Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-329/018	Data: Datum: 22.06.2016	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, me kërkesë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-553-17086 të datës 05.04.2018 të parashtruar nga Emina Coković, nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensimin e demit nga zjarri dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-553-17086 të datës 05.04.2018 të parashtruar nga Emina Coković, për përkrahje financiare për kompensimin e demit të shkaktuar nga zjarri që ju ka djegur shtëpia e banimit dhe i ndahen 1,500.00€ (një mijë e pesëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere 1,000.00€ (një mijë euro) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim; 400.00€ (katërqind euro) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe 100.00€ (njëqind euro) nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Hasib Coković, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Emina Coković, ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-17086 të datës 05.04.2018 me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e demit të shkaktuar nga zjarri.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e lendes shihet se Eminës ju ka djegur shtëpia e banimit, në atë shtëpi kanë qenë duke jetuar vëllai me familje dhe prindërit.

Vëllai i të përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë renovimin e shtëpisë pasi që nuk është i punësuar as nuk ka mjete për të rregulluar shtëpinë për banim dhe për këtë arsye i ndihmohet me mjete financiare.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Hasib Coković, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Hasib Coković, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-330/018	Data: Datum: 25.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-28537 të datës 14.06.2018 e parashtruar nga OJQ "Vision 02", nga Istogu, që ka të bëjë me përkrahje financiare dhe i propozoj Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa Nr.01-400-28537 të datës 14.06.2018 e parashtruar nga OJQ "Vision 02" për përkrahje financiare, dhe i ndahen 500.00€ (pesëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, për përkrahje financiare për manifestimin e "20 Qershorit" ditës së Çlirimit të Istogut e që Drejtoria për Arsim dhe Kulturë në bashkëpunim me OJQ-në "Vision 02" do të organizoj orë letrare me ese me karakter garues, ku do të marrin pjesë shkollat e të gjitha niveleve.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Vision 02", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorisë për Arsim.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: OJQ "Vision 02", Drejtoria për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-331/018	Data: Datum: 25.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. nenit 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, nxjerr:

V E N D I M

1. Kompensohet: Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, anëtarët e komisionit që do të kompensohen për dy mbledhjet të mbajtura nga 50€ për një mbledhje pra gjithsej 100€ për dy mbledhje, janë si me poshtë:
 - 1). Selajdin Bytyqi, nga radhët e LDK-së;
 - 2). Mirushe Sadikaj, nga radhët e PDK-së;
 - 3). Jehonë Haxhijaj, nga radhët e AAK-së;
 - 4). Valbone Kaliqanaj, në cilësinë e ekspertës.
2. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere apo kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Zyrtarja financiare që të bëjë pagesën e mjeteve të cekura në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunal, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-332/018	Data: Datum: 25.06.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me qëllim të verifikimit të punimeve të projekteve: "Mirëmbajtja e rrugëve malore" Loto I, me numër të brendshëm prokurimi 633-018-009-521 të realizuar nga operatori "Horn& Co Kosova" SHPK nga fsh.Lëbusha-Komuna e Deçanit, nxjerr:

V E N D I M

Formohet Komisioni për verifikimin e punimeve të projekteve: "Mirëmbajtja e rrugëve malore" Loto I, me numër të brendshëm prokurimi 633-018-009-521 të realizuar nga operatori "Horn& Co Kosova" SHPK, dhe në komision caktohen:

- 1). Mujë Osmanaj, Zyrtar i Lartë për Silvikulturë, Kryetar Komisioni;
 - 2). Hasan Maxharraj, Zyrtar i Lartë për Shpëztari, Bletari dhe Peshkatari anëtar, dhe
 - 3). Ramë Blakaj, Pylltar i Terrenit, anëtar.
2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën I. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve në projektin e cekur; do të hartojë procesverbalin mbi pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
3. Komisioni do të filloj ti kryej punët menjëherë, si dhe të gjitha punët administrativo-juridike për nevoja të komisionit do t'i kryejë: Zyra e Prokurimit.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, operatori "Horn& Co Kosova" SHPK, Zyra e Prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.333/018	Data Datum: 25.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), më qëllim të formimit të grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit dhe në grupin punues caktohen:

- 1) Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet e Financa, Kryesues i grupit punues dhe përgjegjës;
- 2) Osman Sadikaj, Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 3) Isa Hoxha, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar;
- 4) Beqir Metaj, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar;
- 5) Fatmir Bytyqi, Menaxher i Personelit, anëtar;
- 6) Hatixhe Arifaj, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare;
- 7) Riza Alihajdaraj, Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, anëtar;
- 8) Gani Sylaj, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 9) Zize Bujupaj, Udhëheqëse e Prokurimit, anëtare; dhe
- 10) Avenita Selmanaj, Zyrtare e Pasurisë, anëtare.

2. Grupi punues do të bëjë hartimin e Planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit, do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin Planit të veprimit të cekur me lartë dhe pas përfundimit kopjen e Planit të Veprimit do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij Grupi punues.

3. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që Planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave të auditorit të hartoj për një kohë të shkurtë.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Kryesuesi i grupit punues dhe anëtarët e grupit.

Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Kryesuesi i grupit punues, anëtarët e grupit punues dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-341/018	Data: Datum: 26.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe nënparagrafi 2.4 i paragrafit 2 të nenit 35, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, me qëllim të formimit të Komisionit për miratimin e çmimeve për punë të paparapara për shtëpinë e kulturës në Banjë, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për miratimin e çmimeve për punë të papara për shtëpinë e kulturës në Banjë me numër të prokurimit 633/ 018/ 034/ 535 dhe në komision caktohen:
 - 1) **Isa Hoxha**, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit; kryesues;
 - 2) **Bedri Hajzeraj**, Udhëheqës i sektorit për kulturë, rini dhe sport në Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 3) **Gëzim Ademaj**, Zyrtar i Lartë i prokurimit, anëtar;
2. Komisioni i cekur më lartë ka për obligim që të bëjë miratimin e çmimeve për punë të paparapara për shtëpinë e kulturës në Banjë sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e punës së këtij komisioni.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit, zyra e Kryetarit dhe zyra e prokurimit.
4. Me kopje të vendimit njoftohen: anëtarët e komisionit, zyra e Kryetarit, zyra e prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.342/018	Data: Datum: 26.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenet 77, 84 dhe 87 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2007), në bazë të nenit 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01/400-30099 të datës 26.06.2018 të parashtruar nga Hajrije Kosumi, në Zyrën e Kryetarit, për përkrahje financiare lidhur me motimin e enciklopedisë gjithëkombëtare "Bardhësitë e Atdheut" dhe mori këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr. 01/400-30099 të datës 26.06.2018 e parashtruar nga Hajrije Kosumi, së cilës i ndahen 1,000.00€ (njëmijë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit për përkrahjen dhe realizimin e botimit të enciklopedisë gjithëkombëtare "Bardhësitë e Atdheut"
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Hajrije Kosumit në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: zyra e Kryetarit.
4. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Hajrije Kosumi, Zyra e Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-343/018	Data: Datum: 26.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), nenin 68.1 pika 2 e Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim e kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-2869 e datës 16.01.2018 e parashtruar nga Haxhi Vuthaj nga fshati Lubozhdë, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e tij dhe nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr. 06-553-2869 e datës 16.01.2018, parashtruar nga Haxhi Vuthaj, për ofrim e ndihmës financiare për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Haxhi Vuthajt, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Haxhi Vuthaj, ka parashtruar kërkesën Nr. 06-553-2869, më 16.01.2018, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi dhe miratoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Haxhiu është i sëmurë ka nevojë për shërim, i cili është i kushtueshëm.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Siç u theksua u vendos si në dispozitiv . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Haxhi Vuthaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-345/018	Data: Datum: 28.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe nenit 69, pika 4 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10, me qëllim të organizimit të korrje-shirjeve sa më të suksesshme dhe realizimin e tyre në territorin e Komunës së Istogut, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Shtabi Komunal për korrje-shirje sipas kësaj përbërje:
 - a) Lulzim Shoshi, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, kryesues;
 - b) Beqir Metaj, Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, anëtar;
 - c) Skënder Hasangjekaj, Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
 - d) Mujë Osmanaj, përgjegjës për zhvillim rural dhe shërbime këshillimore, anëtar;
 - e) Haki Belaj, inspektor për preventivë të zjarrit, anëtarë;
 - f) Kushtrim Zogaj, ekspert për mbrojtje të bimëve;
 - g) Hasan Maxharraj, Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, anëtar.
2. Shtabi komunal do të caktoj çmimet për korrje pas konsultimeve dhe marrëveshjes paraprake me kombanjerët dhe me këtë do t'i njoftojmë të gjithë kombajnerët dhe fermerët.
3. Shtabi do të bëjë përcjelljen e fushatës së korrje-shirjeve; do të kujdeset që ato të realizohen dhe kryhen sa më suksesshëm dhe në afat; do të përpiqet që të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet kombajnerëve me fermerëve t'i zgjidhin në mënyrë paqësore; do të njofton rregullisht Kryetarin me ecurinë e fushatës së korrje-shirjeve si dhe do t'i kryej punët tjera që dalin sipas nevojës, rrethanave dhe kushteve momentale në terren.
4. Të gjitha punët juridike-administrative dhe teknike për nevoja të shtabit do t'i kryej Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e shtabit komunal dhe Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
6. Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: anëtarët e shtabit komunal dhe Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-273/018	Data: Datum: 01.06.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses së Sektorit të Prokurimit për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: "Furnizimi me tonerë për nevoja të institucioneve komunale" me numër të brendshmet të prokurimit 633-018-03R-136 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi me tonerë për nevoja të institucioneve komunale" me numër të brendshmet të prokurimit 633-018-03R-136 dhe në Komision caktohen:

- 1). Fazli Stollaj, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative.
Kryetar komisioni;
- 2). Faton Bytyqi, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative anëtar; dhe
- 3). Arta Fetahu, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Furnizimi me tonerë për nevoja të institucioneve komunale" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësi të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

4. Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Zyra e Prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Handwritten signature

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

Handwritten signature



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-274/018	Data: Datum: 01.06.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1, pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-16146 e datës 03.04..2018 e parashtruar nga Bajram Ahmetaj nga Istogu, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërim e tij dhe nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-16146 e datës 03.04..2018, e parashtruar nga Bajram Ahmetaj nga Istogu, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e dhe me propozim të Komisionit i ndahen 100.00€(njëqind euro) prej kategorisë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Bajram Ahmetaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Bajram Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-16146 e datës 03.04..2018, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete për shërimin.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Bajrami është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim e që është mjaft i kushtueshëm.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Siç u theksua u vendos si në dispozitiv . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

